



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJS-2021-013

GJS-2021-014

Dt. 06.12.2021

Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Enver Peci, bazuar në nenin 4 dhe 9 pika 1, paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 të Ligjit nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 7 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores nr. 05/2019, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 06 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET SI E PABAZUAR, ankesa e parashtruesit N.H., nga Peja, ushtruar kundër A.B., kryetar në Gjykatën Themelore në Pejë dhe gjyqtarit F.B..

A r s y e t i m i

Si Autoritet Kompetent, në bazë të nenit 9, paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-057, Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, më datë 08.11.2021, kemi pranuar në kompetencë nga Kryesuesi i KGJK, një ankesë nga N.H., nga Peja, i cili është ankuar ndaj Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, A.B., ndërsa më datë 10.11.2021, Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë ka deleguar lëndën AD/GJTHPE.nr.16/21, dhe ankesën e palës së njëjtë, Kryetarit të kësaj gjykate për vendosje edhe për gjyqtarin F.B.

Bazuar në nenin 6 pika 1 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore për Gjyqtarët, në çdo rast kur ekziston konflikti i interesit tek Autoriteti Kompetent njoftohet Autoriteti Kompetent i instancës më të lartë gjyqësore (sipas nenit 103 pika 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës autoriteti më i lartë gjyqësor është Gjykata Supreme). Kjo instancë konstaton nëse ekziston konflikti i interesit dhe nëse konstaton se konflikti i interesit ekziston, vendos lidhur me çështjen. Në rastin konkret meqenëse Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë, A.B., me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.331/21, të datës 19.04.2021, është përjashtuar nga vendimmarrja lidhur me kërkesën e parashtruesit të ankesës disiplinore në një lëndë penale në Gjykatën Themelore në Pejë P.nr.646/17, dhe arsyeve të cekura në deklaratën e tij, se ankuesi ndaj tij ka parashtrua padi civile me bazë juridike kompensim dëmi, si autoritet kompetent, konstatova se Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë nuk mund të vendos për

ankesën disiplinore si autoritet kompetent ndaj gjyqtarit F.B., pasi që edhe ndaj tij është ushtrua ankesë disiplinore.

Meqenëse ky rast është evidentuar me dy numra, GJS-2021-013 dhe GJS-2021-014 të procedurës disiplinore ndërsa kemi një ankesë disiplinore për kryetarin dhe gjyqtarin në fjalë, është bashkuar lënda disiplinore.

Ankuesi N.H., në ankesën e tij mes tjerash thekson se ka pas një lëndë civile pronësore në Gjykatën Themelore në Pejë, C.nr.1090/15, për të cilën shpreh shqetësime dhe pakënaqësi për parregullsi gjatë zgjedhjes së saj nga disa gjyqtar të asaj gjykate, dhe për këtë pretendon se padrejtësisht është dënuar dhe ka vuajt dënimin 4 vjet e 6 muaj. Pas vuajtjes së dënimit është interesuar të vazhdoj lëndën dhe gjyqtari i rastit F.B., e ka ndërpre procedurën në çështjen kontestimore të tij deri në zgjedhjen paraprake të një lënde tjetër. Pohon se ka verifikua dhe meqenëse nuk ka pas lëndë tjetër, ka propozua gjyqtarit me vazhdua procedurën por gjyqtari nuk ia ka caktua lëndën dhe për këtë arsye ka kërkuar nga kryetari që lënda të delegohet në gjykatë tjetër. Duke menduar se është miratuar kërkesa e tij për delegimin e lëndës thekson se gjyqtari ka pru aktvendim ku e konsideron të tërhequr kërkesën e tij për vazhdimin e procedurës duke dyshuar se kjo ka qenë një kurdisje nga gjyqtari dhe kryetari. Më tutje thekson se ka pas kërkesa për me vazhdua procedura dhe meqenëse ka dyshua në objektivitetin e gjyqtarit ka ushtrua edhe kallëzim penal ndaj tij. Po ashtu shton se sa i përket kryetarit të gjykatës lidhur me kërkesat e tij dhe përgjigjet që i ka marr i konsideron se edhe kryetari e gjyqtari janë në konflikt të interesit pasi që ndaj të njëjtëve ka procedura edhe penale e disiplinore dhe nuk kanë pas drejt të vendosin për kërkesat e tij.

Lidhur me këto pretendime të palës ankuese si autoritet kompetent kam kërkuar nga Kryetari A.B., dhe gjyqtari F.B. të deklarohen. Në deklaratën e tij kryetari B.,pohon se me aktvendimin C.nr.1090/15 të dt.05.10.2020, është hedh poshtë kërkesa e paditësit N.H., për delegimin e lëndës në një gjykatë tjetër si e pa lejuar pasi që i njëjti ka parashtrua kërkesë për përjashtimin e të gjithë Gjykatës Themelore në Pejë. Ndërsa për pretendimet tjera se ka vendos duke qenë në konflikt të interesit sqaron se pas njoftimit se ndaj tij është parashtrua padi civile për këtë fakt është njoftua në muajin mars 2021 dhe menjëherë ka parashtrua kërkesë për përjashtimin e tij nga vendosja lidhur me një kërkesë të z. H., dhe Gjykata e Apelit ka aprovuar ankesën. Për këtë kryetari në fjalë ka ofrua edhe vendimet përkatëse. Thekson se pas pranimit të aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN.nr.331/21 të dt.19.04.2021 nuk ka marrë as edhe një vendim të vetëm meritior përveç përgjigjeje lidhur me statusin e lëndës, duke shtuar se të gjitha vendimet tjera në raport me z. H., i ka marr nënkryetarja e gjykatës N.K.M.. Konsideron se pretendimet e ankuesit janë të përgjithësuara, nuk janë të mbështetura në asnjë provë dhe kanë për qëllim njollosjen e emrit të tij dhe të gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Pejë.

Gjyqtari F.B., në deklaratën e tij pohoi se lëndën kontestuese C.nr.1090/15 e ka pranuar në punë më 18.10.2016, dhe me parashtrësë paditësit N.H., ka kërkuar që të ndërpritet procedura me arsyetim se lidhur me çështjen e njëjtë është edhe një lëndë tjetër në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, kështu që duke respektuar parimin e disponibilitetit gjykata me aktvendimin e datës 26.02.2019 e ka ndërpre procedurën. Me tutje, thekson se me parashtrësën e datës 28.07.2020, N.H., në cilësinë e paditësit ka bërë kërkesë për vazhdimin e procedurës dhe ka kërkuar që të përjashtohen të gjithë gjyqtarët e gjykatës,

pas kësaj Kryetari i Gjykatës ka hedhë kërkesën e paditësit në fjalë si të pa lejuar, ndërsa si gjyqtar ka nxjerr aktvendim me të cilin ka detyruar paditësin që në afat prej 3 ditësh të bashkëngjis dëshmi që vërtetojnë se çështja paraprake ka përfunduar, thekson se pasi që i njëjti nuk ka vepruar ka nxjerr aktvendim me të cilin është konsideruar e tërhequr kërkesa e paditësit për vazhdimin e procedurës si dhe konstatimi në aktvendim se, procedura mund të vazhdoi pasi që të kenë pushuar shkaqet për të cilat është ndërprerë me propozim të njërit prej palëve ndërgjyqjese. Mohon pretendimet e ankuesit N.H., se edhe pasi i njëjti ka bërë kallëzim penal kundër tij si dhe kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore ka vazhduar me procedimin e padive të tij dhe se me aktvendimin e kryetarit të gjykatës ka qenë i përjashtuar në të gjitha lëndët ku palë apo i autorizuar ka qenë N.H., sipas kërkesës së tij. Propozoj që kërkesa e të njetit të refuzohet si e pabazuar.

Pas analizimit të pretendimeve dhe provave të ofruara nga parashtruesi i ankesës dhe provave shtesë të siguruar për këtë çështje disiplinore, pastaj deklarates së kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë, A.B., dhe gjyqtarit F.B., Kryetari i Gjykatës Supreme si autoritet kompetent për shqyrtimin e ankesës disiplinore konstatoj si vijon:

Në Gjykatën Themelore në Pejë është trajtuar lënda civile kontestimore , C.nr.1090/15 ku si paditës ka qenë parashtruesi i ankesës N.H.. Rasti ka qenë në punë te gjyqtarët e ndryshme dhe përfundimisht me këtë lëndë ka qenë i ngarkuar gjyqtari i kësaj gjykate F.B.. Më aktvendimin e datës 26.02.2019 të gjyqtarit F.B., është ndërpre procedura në këtë çështje kontestimore deri në zgjedhjen e çështjes paraprake. Sipas arsytimit të këtij aktvendimi paditësi N.H., me parashtrësën e datës 25.02.2019 ka kërkuar që të ndërpritet procedura gjyqësore deri në përfundimin e një lënde tjetër në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Paditësi në këtë rast ankuesi me parashtrësën e datës 28.07.2020, ka bërë kërkesë për vazhdimin e procedurës dhe të përjashtohen të gjithë gjyqtarët e Gjykatës në Pejë, kjo kërkesë me vendimin e kryetarit është hedhë si e pa lejuar. Gjyqtari i çështjes F.B., me aktvendim e ka detyrua paditësin-ankuesin N.H., që në afat prej 3 ditësh të bashkëngjis dëshmi që vërtetojnë se çështja paraprake ka përfundua dhe meqenëse paditësi në fjalë nuk ka veprua ka nxjerr aktvendim me të cilin është konsideruar e tërhequr kërkesa e tij. Gjatë procedurës paditësi në këtë rast ankuesi ka kërkuar delegimin e kësaj lënde në një gjykatë tjetër. Me aktvendimin C.nr.1090/15 të datës 05.10.2020, kjo kërkesë është hedh poshtë si e pa lejuar pasi që paditësi kishte kërkuar përjashtimin e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Pejë e që hedhja është në përputhje me nenin 69.1 pika (a), e LPK si dhe fakti që kërkesën e njëjtë e kishte përsërit disa herë. Në deklaratën e tij të datës 10.11.2021, Kryetari B., sa i përket pretendimeve të parashtruesit të ankesës, se ka kryer vepër penale konflikt interesi, konstatohet se duke vendosur në tetor të vitit 2021, për kërkesën e palës për delegim të lëndës duke e ditur se i njëjti ka parashtruar padi civile kundër tij me bazë juridike kompensim dëmi, i njëjti pas pranimit të këtij njoftimi, ka parashtruar kërkesë për përjashtimin e tij për vendosje lidhur me kërkesën e z. H., në Gjykatën e Apelit.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të datës 19.04.2021, me numër PN.nr.331/21, kryetari i Gjykatës së Apelit ka aprovuar kërkesën për përjashtim të tij si kryetar për të vendosur lidhur me kërkesën e një lënde ku avokati H.– ankuesi në këtë rast ishte në cilësinë e të akuzuarit. Po ashtu pas ushtrimit të kallëzimit penal ndaj Kryetarit të gjykatës dhe gjyqtarit F.

B. nga ankuesi lidhur me rastin në fjalë, subjektet e ankesës disiplinore nuk kanë marr ndonjë vendim meritator për lëndën në fjalë.

Bazuar në dispozitën e nenit 107 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcaktohet se: “Gjyqtarët gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe veprimet tjera që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësive të tyre si gjyqtar“. Pretendimet në ankesë, kryesisht bazohen në faktin se Kryetari dhe gjyqtari i çështjes padrejhtësisht kanë nxjerr vendime të ndryshme ndaj parashtruesit, gjë që mund të kontestohet në procedurë të rregullt gjyqësore dhe duke shpreh dyshime të përgjithësuara dhe të pa konkretizuara.

Në këtë drejtim sipas vlerësimit tim, Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë dhe gjyqtari i kësaj gjykate F.B., në cilësinë e të ngarkuarit me lëndën kontestuese, nuk mund të konstatohet se ekziston baza e arsyeshme se kanë bërë ndonjërin nga shkeljet e mundshme disiplinore të parapara me në nenin 5 të ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve gjatë kryerjes së detyrave dhe obligimeve me të cilat ngarkohen dhe se të njëjti gjatë vendosjes së këtij rasti secili sipas kompetencave ligjore kanë marrë veprime procedurale sipas Ligjit të Procedurës Kontestimore. Në këtë drejtim kryetari dhe gjyqtari kanë qenë vendimmarrës varësisht kërkesave të ankuesit, dhe kanë shpreh mendimin në kuadër të parimit të pavarësisë dhe diskrecionit të tyre, të vlerësimit të lirë të provave dhe si pasoj, është e pa mundur në këtë formë të cilësohet si shkelje e mundshme disiplinore.

Andaj, për shkak se në parashtrësën e palës, nuk potencohet për ndonjë shkelje konkrete të supozuar Disiplinore të parapara në nenin 5 të ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kryetar i Gjykatës Supreme

Enver Peci

Kopje:

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
2. Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë
3. Arkivit të Gjykatës Supreme.